



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 210/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Diezela” SHPK nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-90245-03-17-2021, me objekt “Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Vorë”, me fond limit 5.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

Ankimues: “Diezela” SHPK
Adresa: Rruga dytësore Tiranë – Durrës, km 14, Vorë, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: “Bujari Petrol” shpk
Adresa: Superstrada Laç-Fush Krujë, km 4.

“Kastrati” sh.a
Adresa: Rruga “Tirana”, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vorë
Adresa: Qyteti Vorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-90245-03-17-2021, me objekt “Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Vorë”, me fond limit 5.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

II.2. Në datën 31.03.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton se më datë 08.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Diezela” SHPK	9.80	I skualifikuar
2. “A&T” SHPK	12.80	I skualifikuar
3. “Bujari-Petrol” SHPK	14.00	I kualifikuar
4. “Kastrati” SHPK	15.20	I kualifikuar

II.4. Në datën 08.04.2021 operatori ekonomik “Diezela” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Nuk plotëson pikën 8. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit të karburantit me karta elektronike, të cilat të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj. Kjo mënyrë do të saktësohet në kontratë.

II.4.1. Në datën 12.04.2021 operatori ekonomik “Diezela” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

Subjekti Diezela SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit (Kërkesë për Propozim) të organizuar nga bashkia Vorë me objekt Blerje Karburanti. Më dt. 08.04.2021 nëpërmjet njoftimit elektronik Operatori Ekonomik “Diezela” SHPK është njoftuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vorë për refuzimin e ofertës së dhënë nga ky subjekt.

Arsyeja e refuzimit sipas KVO, është mosplotësimi i pikës 8 të kriterëve të veçanta sipas Shtojcës 8, me pretendimin që subjekti nuk ka paraqitur deklaratë ofrimi dhe mundësi furnizimi me kartë elektronike të cilat e mundësojnë targën dhe përdoruesin e saj.

Skualifikimi i bërë nga ana juaj është i padrejtë pasi Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit Shtojca 8 pika 8 thekson: “Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit të karburantit me karta elektronike, të cilat duhet të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj, kjo mënyrë do të saktësohet në kontratë (Bashkëngjitur Shtojca 8)

Pra sipas këtij Kriteri të përcaktuar nga ana juaj nuk kërkohet deklaratë nga operatori ekonomik, por saktësimi i saj në kontratë.

Në këto kushte subjekti Diezela SHPK e shikon të jashtëligjshëm skualifikimin nga kjo procedurë duke gjykuar se Autoriteti kontraktor me qëllim ka shkelur Ligjin e Prokurimit

duke skualifikuar ofertën më të ulët, duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues midis operatorëve ekonomikë.

Mendojmë që vlerësimi nga KVO është i padrejtë pasi është shkelur dhe Neni 3 Pika 2 për ngushtimi artificial të konkurrencës për favorizimin ose dëmtimin e një operatori të caktuar. Në këto kushte kërkojmë nga ana juaj: Rishikimin e vendimit të dhënë nga KVO për këtë procedurë prokurimi.

II.4.2. Në datën 14.04.2021 me shkresën Nr. 3147/4 prot operatori ekonomik ankimues “Diezela” SHPK ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 23.04.2021 pala ankimuese “Diezela” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 3529/1 prot datë 29.04.2021 protokolluar me tonën me nr. 688/2 prot datë 04.05.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kundërshtimin e operatorit ekonomik “Diezela” sh.p.k, për sa i përket arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e KVO-së, se: *“Nuk plotëson pikën 8. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit të karburantit me karta elektronike, të cilat të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj. Kjo mënyrë do të saktësohet në kontratë.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se.

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 1.1. përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”*.

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 8 tek “Kapaciteti ekonomik e financiar” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

8. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit të karburantit me karta elektronike, të cilat të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj. Kjo mënyrë do të saktësohet në kontratë.

III.1.3. Për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 8 “Kapaciteti ekonomik e financiar”, të shtojcës 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ofertuesi “Diezela” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

DEKLARATE MBI FURNIZIMIN 24 ORË ME KARBURANT

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 29.03.2021 NGA Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vorë me objekt “Blerje Karburanti” me fond limit: 5.000.000 (pesë million) lekë.

Unë i nënshkruari X. X me cilësinë Administratorit të operatorit ekonomik Diezela SHPK deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Marrim përsipër furnizimin me karburant, sipas specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Vorë, në të gjitha pikat e subjektit Diezela SHPK, gjatë 24 orëve të ditës për të gjitha ditët e zbatimit të kontratës.

Data e dorëzimit të deklaratës: xx/xx/xxxx

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi i ofertuesit

Vula

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Diezela” SHPK ka dorëzuar deklaratën “Deklaratë mbi furnizimin 24 orë me karburant sipas specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor” sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në pjesën “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1 përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin

oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.1.7. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale dokumentet e ofertuesve/kandidatëve, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP vëren se, në Shtojcën 8/2 pika 2.2.8 të dokumenteve të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se:

- *Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit të karburantit me karta elektronike, të cilat të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj. Kjo mënyrë do të saktësohet në kontratë. .*

III.1.9. Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacioni i autoritetit kontraktor, KPP pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Diezela” SHPK “*Deklaratë mbi furnizimin 24 orë me karburant*” dhe kriterit të parashikuar në pikën 2.3.8 nga autoriteti kontraktor, konstatohet se deklarata e dorëzuar nga operatori ekonomik “Diezela”, SHPK është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde, me anë të së cilës operatori ekonomik deklaroi se merr përsipër furnizimin me karburant sipas specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në të gjitha pikat e subjektit Diezela SHPK gjatë 24 orëve për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Nga sa më sipër rezulton se pretendimi i ngritur nga autoriteti kontraktor nuk qëndron pasi operatori ekonomik ka paraqitur deklaratën në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar. Komisioni gjykon deklaratimet e bëra nga operatori ekonomik ankimues në deklaratë janë mëse të mjaftueshme dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për tu garantuar në lidhje me kryerjen me sukses të kontratës dhe sipas grafikut të lëvrimit që ka përcaktuar vetë autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Nga sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ankimuesi ka kapacitet për të ofruar furnizimet/shërbimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, duke dëshmuar se gëzon kapacitete për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Diezela” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Diezela” SHPK, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-90245-03-17-2021, me objekt “Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Vorë”, me fond limit 5.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Diezela” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Diezela” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 688 Protokoli; Datë 23.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri